



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CA-2023-02

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Kai Ambos
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 9 janar 2023

Gjuha në origjinal: Anglisht

Klasifikimi: Publik

Vendim për Gjuhën e Punës

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:
Aleks Uajting

Mbrojtësit të Salih Mustafës:
Julius Von Bone

Mbrojtëses së Viktimave:
Ani Pues

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht “Paneli i Gjykatës së Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”),¹ bazuar në nenin 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 172 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), nxjerr këtë Vendim.

1. Paneli rikujton se, në bazë të nenit 20 të Ligjit dhe duke respektuar plotësisht të drejtat e të akuzuarit në çdo proces gjyqësor, paneli mund të vendosë se cilat gjuhë të punës janë të përshtatshme për atë proces. Gjithashtu, rregulla 8(3)(a) e Rregullores përcakton se në fazën më të hershme të mundshme të procesit, pasi të ketë dëgjuar palët dhe, kur është e zbatueshme, edhe mbrojtësin e viktimave, paneli merr vendimin se cila ose cilat gjuhë të punës të përdoren gjatë procesit.²

2. Më 8 tetor 2020, mbështetur në marrëveshjen ndërmjet palëve,³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake, nxori një vendim ku përcaktoi që “për procesin KSC-BC-2020-05” gjuha e punës të ishte anglishtja, që vazhdoi të zbatohet gjatë fazës së gjykimit të procesit.⁴ Sikurse vuri në dukje Gjykatësi i Procedurës Paraprake, përcaktimi i gjuhës së punës: (i) është i nevojshëm për të siguruar zhvillim të drejtë, efikas dhe të shpejtë të procesit; (ii) mundëson përgatitjen dhe organizimin efikas të parashtrimeve të një pale apo pjesëmarrësi; dhe (iii) shton parashikueshmërinë dhe kapacitetin për planifikim të njërive të përkthimit në Zyrën Administrative dhe në ZPS.⁵

¹ F00002/COR, Versioni i Korigjuar i Vendimit për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 3 janar 2023.

² Termi “proces” interpretohet si “çështje juridike në shqyrtim para një Dhome”. Shih KSC-BC-2020-05, F00032, Vendim për Gjuhën e Punës, 8 tetor 2020 (“Vendim për Gjuhën e Punës”), para. 10.

³ KSC-BC-2020-05, F00025, Parashtrimet e Prokurorisë për Gjuhën e Punës në KSC-BC-2020-05, 2 tetor 2020, para. 7; KSC-BC-2020-05, Transkript, 5 tetor 2020, f. 27. Paneli thekson se të gjitha parashtrimet e dorëzuara nga palët dhe të gjitha vendimet dhe urdhrat e dorëzuar përpara Vendimit për Gjuhën e Punës kanë qenë dorëzuar paraprakisht në anglisht. Shih Vendim për Gjuhën e Punës, para. 12

⁴ KSC-BC-2020-05, F00123, Vendim për Caktimin e Datave për Mbajtjen e Konferencave Përgatitore për Gjykim dhe për Parashtrime nga Palët, 20 maj 2021, para. 7.

⁵ Vendim për Gjuhën e Punës, para. 11.

3. Pas lëshimit të Aktgjykimit më 16 dhjetor 2022,⁶ u caktua një numër i ri çështjeje, KSC-CA-2023-02, në lidhje me fazën e apelit të çështjes, në përputhje me Udhëzuesin përkatës të Punës.⁷ Më 3 janar 2023, z. Salih Mustafa, duke përdorur një numër të ri për çështjen dorëzoi në anglisht “Mocion Urgjent i Mbrojtjes për Shtyrjen e Afatin për Dorëzimin e Njoftimit për Apel”.⁸
4. Duke marrë parasysh sa më lart, Paneli gjykon se është në interes të drejtësisë që anglishtja të vazhdojë të përdoret si gjuhë e punës gjatë fazës së apelit në këtë çështje. Gjithashtu, për zbatimin praktik të këtij vendimi, Paneli pajtohet me udhëzimet e zbatuara gjatë fazës së procedurës paraprake dhe fazës së gjyqimit të kësaj çështjeje.⁹

1. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

VENDOS që gjuha e punës në këtë proces të jetë anglishtja.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse

E hënë, 9 janar 2023

Në Hagë, Holandë

⁶ F00494, Aktgjykimi, 16 dhjetor 2022 (konfidencial) (“Aktgjykimi”).

⁷ KSC-BD-15, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative, Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara në Dhomat e Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019, neni 8.

⁸ F00001, Kërkesë Urgjente e Mbrojtjes për Shtyrjen e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit për Apel, 3 janar 2023.

⁹ Vendim për Gjuhën e Punës, para 14-30, 31(b)-(c).